

VENDIM
Nr. 9/2020

PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT
NR. 99/2017, “PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT ‘PËR QEVERISJEN VENDORE’
NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR
ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E
NJERIUT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21, pika 1 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Pavarur dhe kryetarit të nënkomisionit “Për qeverisjen vendore”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 99/2017, “Për ngritjen e nënkomisionit ‘Për qeverisjen vendore’ në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, të ndryshuar, bëhet shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën III shtohen anëtare të përhershme të nënkomisionit deputetet Elena Xhina dhe Aurora Mara.

2. Në pikën III/1 bëhen ndryshimet si më poshtë:

- a) deputetja Ediola Braha caktohet anëtare zëvendësuese;
- b) deputetja Aurora Mara hiqet si anëtare zëvendësuese.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 17.2.2020.